

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – Departamenti i Krimeve të Rënda, si gjykatë penale e shkallës parë, përmes kryetarit të trupit gjykues Aziz Shaqiri, me sekretaren juridike Kadrije Zymberi, në lëndën penale kundër të pandehurit A. I nga K, rruga p.n., për shkak të veprave penale përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 375 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm KPRK-s), mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s, asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-s dhe pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga 409 paragrafi 1. Të KPRK-s, të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av. L. A nga Gj sipas aktakuzës së ndryshuar të Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për krime të rënda PP.I.nr. 111/2016 të datës 29.09 2016 dhe aktakuzës PP.I.nr. 25/2016 të datës 27.01 të vitit 2016, të cilën e përfaqësoi prokurori i shtetit Agron Uka, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, verbal dhe publik më datën 11 janar 2017 mori dhe në prani të prokurorit të shtetit, të të pandehurit si dhe të të dëmtuarit Sokol Zuzaku në të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

I. I pandehuri A. I. nga babai H dhe nëna S – me mbiemër të vajzërisë H , i lindur më në Gi me vendbanim në. posedues i telefonit mobil me SIM karteletë ... (ky numër është i nënës së tij, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i katër fëmijëve të mitur, ka të kryer shkollën e mesme, i papunësuar në Republikën e Kosovës, me gjendje të mesme ekonomike, i pagjykauar dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale kundër tij, i tërhiqet vërejtja se është i detyruar që ta lajmëroj gjykatën për çdo ndërrim eventual të vendbanimit përkatësisht të vendqëndrimit të tij nën kërcënim të pasojave ligjore për lëshimin e urdhër arrestit e nëse plotësohen kushtet ligjore edhe të letër rreshtimit,

Ë shtë f a j t o r

1.Sepse më datën rreth ores minuta në fshatin, i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka përdor armën e zjarrtë – revolen e markës,,, me caliber ... prodhim serb, me të cilën ka shtënë 6 (gjashtë) here në drejtim të veturës së markës...., ngjyrë e kaltër, me tabela të regjistrimit...., prone e të dëmtuarit Sokol Zuzaku, e cila ishte e parkuar përball dyerve të oborrit të shtëpisë së të dëmtuarit,

- me të cilat veprime ka kryer veprën penale **përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm** nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK-s.

2. Sepse më datën...., rreth ores ... minuta në fshatin, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë edhe atë një revole të markës CZ-99 me caliber 9mm, prodhim serb,

-me të cilat veprime ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 374 paragrafi 1 të KPRK-s,

3. Sepse më datën..., rreth ores ...minuta, në fshatin B, Komuna e K,i pandehur, pas një mosmarrëveshje të mëhershme me të dëmtuarin Sokol Zuzaku, ka dëmtuar veturën e të dëmtuarit të markës " ...", ngjyrë të kaltër, me tabela të regjistrimit., duke shtënë

gjaashtë here me një armë zjarri të markës – revolen e markës CZ-99 kalibër 9mm, prodhim serb, duke dëmtuar pasurinë e luajtshme të të dëmtuarit në vlerë prej 200 Euro,

-me të cilat veprime ka kryer veprën penale **asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë** nga neni 333 paragrafi 1 të KPRK-s,

4. Sepse më datën minuta, në pikën kufitare..., i pandehuri ka penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që gjersa i pandehuri është legjitimuar në pikën e rregullt kufitare dhe ka ofruar dokumentacionin për verifikim të identitetit të tij, duke mos i zbatuar urdhrat e ndaljes përkundër përpjekjeve të zyrtarve policor N.A dhe B.V për ta ndalur, duke i marr çelësat e veturës ...me targa të huaja Zh .. ëshë futur në automjet të cilin e ka ndezur dhe ka ikur me shpejtësi të madhe në drejtim kufirit të Republikës së Serbisë,

-me të cilat veprime ka kryer veprën penale **pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare** nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-s,

5. Sepse më fatën minuta, në banesën e tij në "Qendër" tek rruga ".." në i pandehuri në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka përdorur armën e zjarrt – revolen e markës ... prodhim Jugosllav, me numër serik,... me caliber 7,62 mm, me të cilën ka shtënë 14 jerë në ajër,

- me të cilat veprime ka kryer veprën penale **përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm** nga neni 375 paragrafi 1 të KPRK-s. dhe

6.Sepse më datën 31 dhjetor të vitit 2015 rreth ores 23:50 minuta në banesën e tij " Qendër " në rrugën " Skendërbeu " në Kamenicë, i pandehuri pa autorizim dhe në kundërshtim me Ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrtë edhe atë një revole të markës TT, prodhim Jugosllav, me numër serik AB 1354, me caliber 7.62 mm dhe një karikator me tetë fishekë të të njëjtit caliber, e që pas kontrollit nga pjestarët e Policisë së Kosovës në banesën e tij janë gjetur dhe sekuestruar,

-me të cilart veprime ka kryer veprën penale **mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve** nga neni 374 paragrafi 1. Të KPRK-s.

Kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 80 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2 dhe 2.5 të KPRK-s së pari ka caktuar dënimet edhe atë për veprën penale në pikën 1. dënimin me burgim në kohëzgjatje njëqindnjëzetë (120) ditëve, për veprën penale në pikën 2. dënimin me gjobë në shumën prej 500 Euro, për veprën penale në pikën 3. dënimin me gjobë në shumën prej 300) Euro, për veprën penale në pikën 4 dënimin me gjobë në shumën prej 400 Euro, për veprën penale në pikën 5. dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqindnjëzetë (120) ditëve, dhe për veprën penale në pikën 6. dënimin me gjobë në shumën prej 500 Euro.

Gjykata në bazë të dispozitave të cituara, nenit 4, 7, 21, 41, 45, 46, 73, 74 dhe 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s si dhe nenit 365 të Kodit të procedurës penale (KPP-s) të pandehurit në fjalë,

I SHQIPTON DËNIM UNIK ME BURGIM DHE GJOBË

Edhe atë :

-dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej **njëqindetëdhjetë (180) ditëve**, i cili me pëlqimin shprehimisht të dhënë nga ana e të pandehurit në kuptim të nenit 47 të KPRK-s,

I ZËVENDËSOHET ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej **tremijëegjashtëqind (3,600) Euro**, të cilin detyrohet që ta përmbush në afat prej tre muajve, në këste të barabarta prej nga 1,200 Euro, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo nëse i pandehuri këtë shumë nuk e paguan sipas këtij aktgjykimi, dënimi me gjobë i zëvendësuar revokohet dhe i pandehuri detyrohet që ta mbaj dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditëve, përkatësisht në mënyrë përpjestimore me gjobën e papaguar.

dhe

-dënim unik me gjobë në shumën prej njëmijë e shtatqind (1,700) Euro, në afat prej 30 ditëve, duke filluar nga dita pasuese e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, mirëpo në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj këtë shumë të dënimit me gjobë,

i njëjti i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetëdhjetëepesë (85) ditëve, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Të pandehurit në kuptim të nenit 83 paragrafi 2 të KPRK-s në dënimin me gjobë duhet t'i llogaritet gjoba e shqiptuar në shumën prej **130 Euro**, e shqiptuar me aktvendim të plotfuqishëm të Gjykatës themelore në Gjilan – dega në Kamenicë – Divizioni për kundërvajtje Regj. Nr. 937/2016 të datës 10.10 2016, pasi që në veprimet e të pandehurit përveç kundërvajtjes nga neni 32.4 të Ligjit për sigurinë e komunikacionit rrugor ekzistojnë edhe elementet e veprës penale nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-s, për të cilën është shapllur fajtor dhe dënuar sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

II. Të pandehurit në fjalë i shqiptohet edhe **dënimi plotësues** në kuptim të nenit 374 paragrafi 3 lidhur me nenin 69 të KPRK-s, duke ju konfioskuar një revole e markës..T, prodhim Jugosllav, me numër serik....., një karrikator i revoles si dhe tetë fishekë të të njëjtit kaliber sipas raportit të këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër të dosjes së hetimeve ...të datës 08.12 2015, ku përpilues i këtij raporti ka qenë zyrtarja policore me DI#959, të cilat duhet të shkatërrohen përmes komisionit profesional të formuar nga kryetari i kësaj gjykate ose në koordinim me te, duke u konstatuar me procesverbal, po qe se nuk vendoset ndryshe konform dispozitave të LESP-e.

II. DETYROHET i pandehuri në fjalë që kësaj gjykate t'ia paguaj shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor në shumën prej **dyzetë (40) Euro**, në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Arsyetim

Organi i ndjekjes penale kundër të pandehurit në fjalë ka paraqitur dy aktakuza lëndore edhe atë për shkak të dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer gjashtë vepra penale lëndore.

Kryetari i trupit gjykues ka caktuar me urdhresë seancën e shqyrtimit fillestar duke i ftuar palët, të dëmtuarin si dhe mbrojtësinë profesional të caktuar sipas detyrës zyrtare.

Kryetari i trupit gjykues sipas radhës ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe palën e dëmtuar, si dhe mbrojtësen e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Pasi që i pandehuri gjatë seances së shqyrtimit fillestar ka pranuar fajësinë gjykata pas marrjes së mendimit nga ana e prokurorit të shtetit por edhe të të dëmtuarit Sokol Zuzaku, në kuptim të nenit 248 paragrafi 1 të KPP me aktvendim procedural ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për të gjitha veprat penale, duke vërtetuar se janë plotësuar kushtet ligjore.

Vlen të theksohet se i pandehuri në seancën e radhës ka pranuar fajësinë edhe për veprën penale nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-s, duke ia dorëzuar gjykatës një kopje të aktvendimit nga Divizioni kundërvajtës Regj.nr. 937/16 të datës 10.10 2016 i cili pasi që është bërë i plotfuqishëm, gjoba së bashku me paushallin gjyqësor është paguar më

datën 06.01 2017 për kundërvajtje e cila është e lidhur me veprën penale nga neni 409 paragrafi 1 të KPRK-s, përkitazi me shkeljen e dispozitës ligjore përkatëse.

Prokurori i shtetit në deklaratën e tij ka theksuar se mbetet në tërësi pranë gjashtë akuzave të përshkruara dhe të kualifikuara në aspektin juridik sin ë dy aktakuzat lëndore me numër dhe data të lartcekura, duke i propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor për gjashtë akuzat lëndore, e me rastin e vendosjes t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke i propozuar gjykatës që të merr parasysh të kaluarën kriminale të të pandehurit sipas lëndëve penale të shenuara me PP.

I dëmtuarideklaroj se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale por edhe nuk ka kurrëfarë kërkesë pasurore juridike ndaj të pandehurit.

Mbrojtësja e të pandehurit e caktuar sipas detyrës zyrtare av. L. A deklaroj se i akcepton të gjitha rrethanat lehtësuese të theksuara nga prokurori i shtetit duke shtuar se si rrethanë lehtësuese duhet të merret fakti se i dëmtuari nuk i është bashkëngjitur ndjekjes penale dhe nuk ka kërkuar kurrëfarë kërkesë pasurore juridike ndaj të pandehurit, duke theksuar se për atëngjarje mban përgjegjësi por ajo është e karakterit personal dhe nuk është e nevojshme të theksohet, se është mbajts i vetëm i familjes, se fatkeqësisht është konsumues i alkoolit dhe në disa raste kur konsumon sasi të konsiderueshme të pijeve alkoolike del jashtë kontrollit duke mos qenë në gjendje që të kontrolloj sjelljet e tij, duke premtuar seriozisht se ka vendos që në të ardhmen mos ta konsumoj alkoolin sepse llogarit se shkak i shumë problemeve pikërisht është konsumimi i alkoolit, se është penduar për veprimet e tij të pamatura, e duke i pasur parasysh gjykata këto rrethana të i ka propozuar që të pandehurit t'ia shqiptoj një dënim të arsyeshëm me qëllim që me të njëjtin të arrihet qëllimi i plotë i dënimit.

I pandehuri ka deklaruar se e mbështet deklaratën e mbrojtëses së tij, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme, duke u përmbajtur nga veprimet e pamatura, duke kërkuar nga gjykata mirëkuptim duke ja dhënë edhe një ashmans sepse i njëjti është me punë në ...dhe se një dënim i lart do t'i shkaktoj probleme për vazhdimin e punës dhe mbajtjen e familjes për të siguruar ekzistencën e tij.

Kryetari i trupit gjykes me qëllim që mos ta mbështesë aktgjykimin vetëm në pranimin e fajësisë së të pandehurit, për gjashtë veprat penale, në kuptim të nenit 361 të KPP ka vlerësuar deklaratën e të pandehurit, të dëmtuarit por edhe provat tjera material në shkresa të lëndës dhe ka vërtetuar gjendjen faktike si në gjashtë pikat në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e shpallur fajtor për të njëjtat dhe shqiptuar dënimet unike me burgim dhe me gjobë, e sipas pëlqimit të dhënë shprehimisht nga i pandehuri në kuptim të nenit 47 të KPRK-s, dënimi unik me burgim prej 180 ditëve është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej 3600 Euro.

Të gjitha elementet objektive dhe subjektive lidhur me veprat penale lëndore nuk janë kontestuese, në bazë të provave të vlerësuara në shkresa të lëndës të cilave gjykata jua ka falur besimin e plotë, e të njëjtat nuk i ka kundërshtuar as i pandehuri meqë ka pranuar fajësinë për gjashtë veprat penale lëndore, sipas përshkrimit faktik dhe kualifikimit juridik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pra, nuk janë kontestuese as elementet subjektive tek secila vepër penale lëndore, e të cilat konsistojnë në dashje, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshtëm se me veprimet e tij hynë në zonën kriminale penale, duke mbajtur dhe përdorur armët me karakteristika të përshkruara si në dispozitiv, duke dëmtuar veturën e të dëmtuarit – pra duke shtën me armë në te, por edhe duke penguar zyrtarët policor në kufirin lëndor për ta legjitimuar të njëjtin – duke mospërfillur urdhrat por edhe përpjekjet e zyrtarëve policor për ta ndalur, e të cilët janë larguar në një moment të caktuar pasi që i akuzuari ka hyrë në automjetin lëndor me targa të huaja, e ka dhezur dhe me shpejtësi të madhe është nisur në drejtim të kufirit të Republikës së Serbisë, por edhe e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të tij

kriminale, edhe pse ka mundur që të përmbahet nga veprimet e tilla duke i kontrolluar sjelljet e tij kriminale të përshkruara në gjashtë pikat e dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Duke pasur parasysh gjendjet faktike të vërtetuara më lart, por edhe elementet objektive dhe subjektive lidhur me këto çështje penale gjykata ka vërtetuar se i pandehuri është penalisht përgjegjës për gjashtë veprat penale të përshkruara dhe të kualifikuara në aspektin juridik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimeve ndaj të pandehurit, gjykata sipas nenit 73 dhe 74 të KPRK, por edhe nenin 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të KPRK-s ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për gjashtë veprat penale, pendimin e sinqert për veprimet e pamatura të tij edhe pse nën ndikimin e alkoolit, premtimin serioz se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, mosbashkëngjijtjen e të dëmtuarit ndjekjes penale duke mos paraqitur kurrëfarë kërkesë pasurore juridike lidhur me dëmin e shkaktura në veturën e tij, se është mbajtës i vetëm i familjes me punën e tij personale në Zvicër, se është i pagjykuar pasi që organi i ndjekjes penale nuk ka ofruar kurrëfarë prove valide – aktgjykim të plotfuqishëm në gjykatë por edhe ndonjë aktakuzë edhe pse i pandehuri nuk mund të trajtohet recidivist pa aktgjykim të plotfuqishëm për vepra penale, por edhe faktin se i pandehuri veprimet kriminale të tij i ka ndërmarr nën ndikimin e alkoolit pasi që është konsumues i pasionuar i alkoolit, por kryerja e veprave penale nën ndikimin e alkoolit nuk e përjashton përgjegjësinë penale të të pandehurit. Kurse rrethana rënduese nuk ka gjetur edhe pse në anën tjetër akuzohet për gjashtë vepra penale të ndryshme përkatësisht të katër veprave penale të natyrës së njëjtë përkthësisht të ngjashme.

Gjykata duke pasur parasysh gjendjet faktike të vërtetuara përkthësisht me veprat penale, por edhe rrethanat lehtësuese të cekura më lart me theks të veçantë se i njëjti gjendet me punë në Zvicër dhe me ato mjete mban familjen e tij, e këto rrethana i ka vlerësuar në kuptim të nenit 75 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të KPRK-s, duke u bindur se edhe me dënimet unike me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv mund të arrihet qëllimi i plotë i dënimit në kuptim të nenit 41 të KPRK-s, duke e resocializuar të pandehurin por edhe duke e parandaluar që në të ardhmen mos të kryej vepra penale, kurse qytetarët potencial do t'i disiplinon që në të ardhmen most ë kryejnë vepra penale, duke respektuar të mirat juridike të mbrojtura me ligjet penale të vendit.

Gjykata në kuptim të nenit 80 paragrafi 1 dhe 2 nënparagrafi 2.2, 2.4 dhe 2.5 të KPRK-s së pari ka caktuar dënimet për të pandehurin, e pastaj ka shqiptuar dënimet unike me burgim dhe me gjobë si në dispozitiv.

Pasi që i pandehuri shprehimisht ka dhënë pëlqimin që dënimi unik me burgim prej 180 Euro t'i zëvendësohet me dënim me gjobë, gjykata në kuptim të nenit 47 të KPRK-s të pandehurit i aka zëvendësuar dënimin unik me burgim me dënim me gjobë, duke ia tërhequr vërejtjen të pandehurit se ky dënim i zëvendësuar mund të revokohet duke u detyruar i pandehuri që ta mbaj dënimin e shqiptuar unik me burgim ose përpjestimisht me gjobën e papaguar me rastin e zëvendësimit të dënimit me burgim me atë me gjobë. Ndërsa lidhur me dënimin unik me gjobë të pandehurit në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s e ka njoftuar se nëse nuk done ose nuk mund ta paguaj dënimin unik me gjobë prej 1,700 Euro në tri këste të barabarta në afat prej tre muajve, atëherë ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 85 ditëve në kuptim të nenit 46 paragrafi 3 të KPRK-s, të cilin dënim i pandehuri duhet ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në kuptim të nenit 83 paragrafi 2 të KPRK-s parashihet se ndër të tjera nëse i pandehuri ka paguar dënimin me gjobë për kundërvajtje elementet e së cilës përfshihen edhe në elementet e veprës penale atëherë në dënimin me gjobë ose me burgim do të llogaritet edhe dënimi me gjobë i paguar nga i pandehuri për kundërvajtjen e tij sipas aktvendimit

përkatësisht aktgjykimit të plotfuqishëm. Në rastin konkret i pandehuri me aktvendimin e plotfuqishëm të GJTH në Gjilan – dega në ë – divizioni kundërvajtës Regj.nr. 937/16 të datës 10.10 2016 është dënuar me gjobë në shumlën prej 130 Euro për kundërvajtjen nga neni 32.4 të LSKRR pasi që gjatë drejtimit të veturës së llojit BMW me targa Zh 589 539 nuk ka vepruar sipas urdhrave të policisë për ta fikur veturën dhe t'i marr çelësat e veturës për t'ia dorëzuar policisë kufitare, mirëpo këtë nuk e ka përfillur duke lëvizur me shpejtësi të madhe me veturë në drejtim të kufirit të Serbisë. Në rastin konkret ky i pandehur duke penguar detyrën zyrtare të policëve kufitar për ta identifikuar të pandehurin, i njëjti duke mos përfillur urdhrat e policisë dhe përpjekjet e tyre për ta ndaluar ka dhezuar veturën në fjalë dhe me shpejtësi të madhe ka lëvizur me veturën në fjalë e për hir të sigurisë së tyre personale zyrtarët policor janë larguar në mënyrë që most ë pësojnë pasoja nga lëvizja e veturës të cilën e drejtonte i pandehuri. Kështu që ky dënim prej 130 Euro meqë është paguar sipas fletpagesave në shkresa të lëndës më 06.01 2017 për kundërvajtjen lëndore, gjykata këtë gjobë i aka llogaritur në dënimin unik me gjobë prej 1,700 Euro konform nenit 83 paragrafi 2 të KPRK-s siç është theksuar më lart. Kryetari i trupit gjykues në kuptim të nenit 368 të KPP pas shpalljes së aktgjykimit, palët i ka udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke e njoftuar të pandehurin me pasojat e mospërfilljes së aktgjykimit lëndor nga i pandehuri.

Lidhur me konfiskimin e armës lëndore me karrikator dhe fishekë gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 374 paragrafi 3 të KPRK-s, kurse lidhur me mos konfiskimin e armës së markës... prodhim serb gjykata nuk ka vendosur që ta konfiskoj pasi që prokurori i shtetit nuk ka propozuar as në aktakuzë e as gjatë seancës gjyqësore porn ë anën tjetër në shkresa të lëndës nuk ka prova për sekuestrimin e saj nga ana e organeve shtetërore përveç provave materiale lidhur me atë se me ...është goditur vetura e pales së dëmtuar,e përmes tyre është vërtetuar marka dhe kalibri i armës lëndore.

Gjykata lidhur me kërkesën pasurore juridike të palës së dëmtuar nuk ka vendosur pasi që i njëjti nga një kërkesë e fillë ka hequr dorë duke mos iu bashkëngjitur as ndejejs penale ndaj të pandehurit në fjalë.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës penale përkitazi me paushallin gjyqësor vendosi në kuptim të nenit 450 lidhur me nenin 453 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda
PKR.nr. 169/2016 dhe PKR.nr. 26/2016 , më dt.11 janar të vitit 2017**

Sekretarja juridike,
Kadrije Zymberi

Kryetari i trupit gjykues,
Aziz Shaqiri,**d.v.**

Udhëzim për mjetin juridik: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.

Ankesa në kopje të mjaftueshme dorëzohet përmes kësaj Gjykate.